

**KËRKESË**  
**Nr. 4743/2, datë 30.5.2019**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksion i rrugës Plastmas-Karbunarë”, Lushnjë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 25 480 (njëzet e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë.

ZËVENDËS MINISTËR I  
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
**Artan Shkreli**

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA  
REALIZIMI I PROJEKTT: “RIKONSTRUKSION I RRUGËS PLASTMAS-KARBUNARË”, LUSHNJË

| Nr.                         | Emër mbiemër      | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sipërfaqja totale (m <sup>2</sup> ) | Sipërfaqe shpronësimi     | Çmimi                     | Vlera totale / lekë | Shënime Konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja |
|-----------------------------|-------------------|-----------------|----------------|-------------------------------------|---------------------------|---------------------------|---------------------|----------------------------------------|
|                             |                   |                 |                |                                     | tokë arë / m <sup>2</sup> | tokë arë / m <sup>2</sup> |                     |                                        |
| 1                           | Hysni Selman Demo | 2087            | 618/10         | 500                                 | 70                        | 364                       | 25,480              | Konfirmuar nga ZVRPP-ja                |
| Vlera totale e shpronësimit |                   |                 |                |                                     |                           |                           | 25,480              |                                        |